



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3182/17 prot.

Datë 08.02.2024

**V E N D I M**

**Nr. 161/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 112/2024, datë 30.01.2024, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91618-12-19-202, me objekt: “Loti 2: “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%”, me fond limit 63,925,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë  
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133,Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 30.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 112/2024, ku vendosi:  
[...]

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91618-12-19-202, me objekt: “Loti 2: “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%”, me fond limit 63,925,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 18366/22 prot., datë 06.02.2024, (dërguar në adresën e emailit të KPP), protokolluar me tonën nr.3182/13 prot., datë 07.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin 112/2024, datë 30.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91618-12-19-202, me objekt: “Loti 2: “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%”, me fond limit 63,925,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjiellës Kanalizime Tiranë. Shkresën nr. 18366/22 prot., datë 06.02.2024 autoriteti kontraktor e ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, shkresë e cila është protokolluar me nr.3182/14, datë 08.02.2024.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 18366/22 prot., datë 06.02.2024, (dërguar në adresën e emailit të KPP), protokolluar me tonën nr.3182/13 prot., datë 07.02.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin 112/2024, datë 30.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91618-12-19-202, me objekt: “Loti 2: “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%”, me fond limit 63,925,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetës Kanalizime Tiranë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, shtojcë e cila nuk është në përputhje me vendimin nr.112/2024, datë 30.01.2024 të këtij Komisioni.

II.2. Në nenin 24, pika e ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet se: "3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, te cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe eficienten, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit."

Ndërsa në nenin 118 pika 2 të po këtij ligji parashikohet: "2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji,

*d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik."*

II.2.1. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të parashikuar nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të KPP. Gjykimi i themelit të çështjes gjatë vendimmarrjes së organit kolegjial, bazohet në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe materialeve të tjera të administruara gjatë shqyrtimit administrativ. Sa më sipër, vendimmarrja e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, përbën dhe zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimmarrjes dhe eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësi të pakuptimtë.

II.3. KPP, në pikën III.1.4. të vendimit nr. 112/2024, datë 30.01.2024, është shprehur:

*III.1.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet, se Autoriteti Kontraktor e ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik shtojcën me ndryshimet përkatëse, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për të cilën nga ana e operatorit ekonomik ankimes nuk ka pasur ankesë.*

***Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.3182 prot., datë 21.12.2023 të operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK.***

Lidhur me këto konstatime të Komisionit, autoriteti kontraktor në shtojcën e hartuar në datën 06.02.2024, në zbatim të vendimit të KPP nr. 112/2024, datë 30.01.2024, ka hequr vetëm kriterin 2.9 (lidhur me certifikatën nr.RECH të prodhuesit), të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe nuk ka hequr kriterin 2.7 (lidhur me Certifikatën SSH 45001:2018 e vlefshme mbi "Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë). Ndërkohë KSHA lidhur me këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimes është shprehur: "...Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë dhe për rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do ju bëjë me dije nëpërmjet hartimit të një shtojce". Për më tepër, shtojcën e publikuar në datën 29.12.2023 pas vendimit të KSHA, autoriteti kontraktor e ka hartuar në përputhje me vendimmarrjen e KSHA-së. Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të pasqyruar këtë ndryshim në përputhje të plotë me konstatimet e KPP-së të shprehura në vendimin nr. 112/2024, datë 30.01.2024, duke hequr kriterin 2.7, lidhur me Certifikatën SSH 45001:2018, e vlefshme mbi "Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

II.4. KPP, në pikën III.2.7. të vendimit nr. 112/2024, datë 30.01.2024, është shprehur:

*III.2.7. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për sigurimin e produktit sa më cilësor me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin*

konkret, KPP vëren se operatori ekonomik kërkon ndryshimin e standardit të Acidit Klorhidrik nga S SH EN 939:2009, i përcaktuar në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, duke u vendosur në përputhje me Standardet Shtetërore Shqiptare, të njohura nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Ministria e Shëndetësisë.

Marrë shkas nga ankesa e operatorit ekonomik ankimues "Albania Distribution Chemical" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me shkresë Institutit të Shëndetit Publik, si institucion përgjegjës për shëndetin publik dhe njëkohësisht institucion përgjegjës për kryerjen e analizave toksikologjike. Instituti i Shëndetit Publik në përgjigje të kërkesës së KPP, lidhur me standardin që përdoret për këtë produkt, ka informuar, se Për vlerësimin e produktit Acid Klorhidrik 30-33% përdoret Standardi SSH EN 939: 1999 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor- Acidi Klorhidrik".

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë shtojcën 5, sa i përket standardit për Acid Klorhidrik 30-33%, sipas kthim përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik.

Gjithashtu, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë/unifikojë kudo në dokumentet e tenderit standardin për Acid Klorhidrik 30-33%, sipas kthim - përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Lidhur me këto konstatime të Komisionit, autoriteti kontraktor në shtojcën e hartuar ka pasqyruar ndryshimin në zbatim të vendimit të KPP-së nr. 112/2024, datë 30.01.2024, vetëm sa i përket standardit të Acid Klorhidrik 30-33%, në rubrikën **2.Treguesit cilësor dhe karakteristikat kimike të kimikateve** të shtojcës 5, por nuk ka modifikuar/unifikuar kudo në dokumentet e tenderit standardin për Acid Klorhidrik 30-33%, sipas kthim - përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik. Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të pasqyruar këtë ndryshim në përputhje të plotë me konstatimet e KPP-së, të shprehura në vendimin nr. 112/2024, datë 30.01.2024.

II.5. KPP, në pikën III.7.4.të vendimit nr. 112/2024, datë 30.01.2024, është shprehur:

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me mallin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere apo specifikime të cilat mund të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në cilësinë e shërbimit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit konstatohet, se ankimuesi kërkon modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.11 të "Kapacitetit teknik", e më konkretisht të mospërcaktimit të IKV e IFBZ, si laborator për kryerjen e analizave të parametrave të mallit objekt - prokurimi. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi paraqitjen e fletë analizës nga ISHP për analizat si më poshtë : Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd),Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të bëhet në një laborator të licencuar (vendas ose të huaj), Qendër Kërkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpërmendura.(Për të gjithë elementët te cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë

*i kërkesës së autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet pjesëmarrëse disponojnë fletë - analizë për parametrat më sipër shënuar për produktin që prokurohet. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e fletë-analizës si më sipër cituar, i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Në këtë mënyrë KPP gjykon, se fletë-analiza në fjalë është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Pas kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, ISHP me shkresën nr.49/1 prot., datë 24.01.2024, ka informuar KPP se : Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3181/5 Prot, datë 10.01.2024, ku kërkonte informacion lidhur me disa standarde për produktet për trajtimin e ujit të pijshëm, përkatësisht për produktet Poliklorur alumini 10+ 0.5%, hipoklorit natriumi 13-15% dhe acid klorhidrik 30-33%, dhe analizat toksikologjike që kryhen për këto produkte në ISHP, ju bëjmë me dije si vijon:*

*A. .... Në produktin Hipoklorit Natriumi në ISHP analizohen këta tregues: klor aktiv (titulli Cl<sub>2</sub>), kadmium, krom, nikel, plumb. Për analizimin e këtyre treguesve, përdoren metoda analitike të bazuara në Standardin SSH EN 901: 2007 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor Hipokloriti i natriumit", i cili përshkruan edhe metodat analitike që duhet të përdoren për analizimin e këtij produkti. ...” .*

*Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kërkesën për kualifikim që ofertuesit të paraqesin fletë analize të lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik për ato parametra që i realizon ky institucion, dhe për analizën e parametrave që nuk kryhen nga ky i fundit, autoriteti kontraktor, ka parashikuar mundësinë që këto analiza të kryhen edhe nga laboratorë të tjerë shtetëror apo privat të licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe ka përcaktuar si të tillë, laboratorin e Institutit të Kërkimeve Veterinare (IKV) dhe laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar(IFBZ). Nga verifikimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), nuk rezulton që IKV dhe IBZ, të jenë në listën e organeve të akredituara. Në këtë kuadër, nga shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave në lidhje me këtë procedurë prokurimi, nga përgjigjja e ISHP-së me përmbajtje si më sipër cituar, si dhe nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të DPA, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet ta rishikojë këtë kriter duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja të cilat mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu, në përcaktimin e këtyre organeve ose institucioneve konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja, autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre llojeve analizash. Për sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete të akredituara, që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre llojeve analizash toksikologjike.*

*Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimmues qëndron.*

Lidhur me këto konstatime të Komisionit, autoriteti kontraktor në shtojcën e hartuar në zbatim të vendimit të KPP-së nr. 112/2024, datë 30.01.2024, nuk ka përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete të akredituara, që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre llojeve analizash toksikologjike. Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të pasqyruar këtë ndryshim në përputhje të plotë me konstatimet e KPP-së të shprehura në vendimin nr.112/2024 datë 30.01.2024.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91618-12-19-202, me objekt: “Loti 2: ‘Blerje Acid Klorhidrik 30-33%’”, me fond limit 63,925,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjellës Kanalizime Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së mësipërme, sipas përcaktimeve në paragrafin III.1.4, III.2.7 dhe III.7.4, të Vendimit Nr. 112/2024, datë 30.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe të publikojë në SPE shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

